

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

1 Informacion i pergjithshem

Shoqeria CFO Pharma shpk, me poshte “Shoqeria”, eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne Dhjetor 2016 nga bashkimi per perthithje i Omega Farma sh dhe CFO Pharma me NUIS K22305002U, me nje vlere kapitali te paguar prej 918,000,000 LEK. Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise perfshin ("Import-eksport medikamente e lende te para e le licensuara nga organet e tjera kompetente ne rastet kur kerkohet. Tregtim me shumice e pakice te artikujve farmaceutik. Import-eksport paisjesh mjeksore, reagenteve dhe kiteve, servis paisjesh mjeksore dhe mirembajtje. Cdo aktivitet ndimes ne perputhje me ligjislacionin shqiptar i cili i sherben aktivitetit te saj kryesor.

Administratori i shoqerise eshte Z. Frigul Milla me afat emerimi deri me 13.09.2021. Kapitali i shoqerise i cili perbehet nga nje kuote, zoterohet 100%, nga ortaku i vetem, z, Nadir Çausholli, ne vleren 2,200,000,000 leke. Me 31 Dhjetor, 2019 Shoqeria kishte 240 te punesuar. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen Autostrada Tr, - Drr, Rruga Pavaresia, Nr, 1, Mezez Kashar, Tirane.

Pasqyrat financiare te Shoqerise per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019 jane miratuar nga Administratori i Shoqerise, Frigul Milla.

2 Bazat e pergatitjes

2.1 Baza e perputhshmerise

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (“SNRF”) publikuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (“BSNK”) dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Nderkombetare te Raportimit Financiar (“KINRF”) te BSNK. Zbatimi i SNRF-ve eshte sipas Ligjit Nr.25 date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur duke u bazuar ne koston mesatare.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare jane pasqyruar ne “Lek” e cila eshte monedha funksionale e shoqerise.

2.4 Perdorimi i gjykimit dhe i vleresimeve

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon qe drejtimi i shoqerise te beje gjykime. vleresime dhe supozime qe mund te ndikojne ne aplikimin e politikave si dhe vlerave te raportuara te aktiveve dhe detyrimeve. te ardhurave dhe shpenzimeve. Vleresimet dhe supozimet kryesore jane rishikuar ne menyre te vazhdueshme.

Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi rishikohet dhe ne çdo periudhe te ardhshme ne te cilen mund te kete ndikim.

3 Politika kontabel te rendesishme

3.1 Aplikimi i Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar te reja dhe te rishikuara (vazhdim)

Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende te papervetesuara

Nje numer standardesh, amendimesh dhe interpretimesh hyjne ne perdorim per here te pare per periudhat qe fillojne ne 1 Janar 2020 ose pas kesaj date, e megjithate Shoqeria nuk i ka aplikuar keto standarde te reja ose te rishikuara ne pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare. Asnje standard i ri nuk pritet te aplikohet me heret nga Shoqeria.

Standarde te cilat akoma nuk kane hyre ne fuqi nuk pritet te kene ndonje ndikim material ne pasqyrat financiare te Shoqerise ne momentin e aplikimit fillestar jane si me poshte vijon:

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

Efektive qe prej 1 Janarit 2020

- Perditesime te Referencimeve ne Kuadrin Konceptual te standardeve SNRF
- Perkufizimi i nje Biznesi (Perditesime te SNRF 3)
- Perkufizimi i te qenit Material (Perditesime ne SNK 1 dhe SNK 8)

3.2 Parimi i vijimesise

Pasqyrat financiare te shoqerise jane pergatitur ne perputhje me parimin e vijimesise, i cili supozon se shoqeria do te vazhdoje te operoje per nje periudhe te parashikueshme ne te ardhmen. Drejtimi i shoqerise beson se ka aktive te mjaftueshme dhe se ka marre te gjitha masat e nevojshme per te siguruar qendrueshmeri dhe zhvillim te biznesit te shoqerise ne kushtet aktuale. Aftesia e shoqerise per te vazhduar aktivitetin do te varet gjithashtu dhe nga mbeshtetja e vazhdueshme financiare nga aksioneret e saj.

3.3 Transaksione ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj jane konvertuar ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Te gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i kembimit qe rezultojne nga kryerja e ketyre transaksioneve dhe nga rivleresimi i zerave monetare ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fundit te vitit njihen ne fitim ose humbje.

Zerat jo-monetare nuk ri kembehen ne fund te periudhes dhe maten me kosto historike (kembehen duke perdorur kursin e kembimit ne date kur eshte kryer transaksioni), pervec rasteve kur zerat jo-monetare maten me vlere te drejte te cilat kembehen duke perdorur kurset e kembimit ne daten kur eshte percaktuar vlere e drejte.

Kurset zyrtare te aplikuara (Lek kundrejt monedhave te tjera te huaja) per monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 jane si me poshte:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
USD	108.64	107.82
EUR	121.77	123.42
		123.43

3.4 Aktivitet afatgjata materiale

(i) *Njohja dhe matja*

Zerat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin nese ka. Kostot historike perfshijne shpenzimet te lidhura drejtperdrejte me blerjen e aktivitet. Kostot e aktiveve te ndertuara vete perfshijne koston e materialeve dhe te punes se shpenzuar, si dhe cdo kosto tjeter qe lidhet me sjelljen e aktivitet ne kushte pune per qellimin per te cilin jane krijuar, kostot e cmontimit dhe zhvendosjes se aktivitet dhe kthimit te vendit te punes ku aktivitet ishte vendosur ne gjendjen e tij fillestare dhe kostot e huamarrjes qe lidhen me aktivitet e kualifikuar per t'u kapitalizuar. Kur pjese te ndryshme te aktiveve afatgjata materiale kane jetegjatesi te ndryshme te dobishme, ato kontabilizohen si pjese me vete (komponente kryesore) te aktiveve afatgjata materiale.

(ii) *Kostot e mepasshme*

Kosto e zevendesimit te pjeseve te aktiveve afatgjata materiale i shtohet vleres se mbartur te aktivitet vetem ne qofte se parashikohet qe kjo pjese te sjelle perfitime ekonomike ne te ardhmen per shoqerine dhe kosto mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te perdritshme te aktiveve materiale afatgjata njihen ne shpenzimet e periudhes kur ndodhin.

(iii) *Zhvleresimi (Amortizimi)*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden lineare apo zbritese te amortizimit. mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivitet afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivitet e

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndertesa	Mbi vleren kontabel neto	5%
Makineri dhe pajisje	Mbi vleren kontabel neto	20%
Mjete transporti	Mbi vleren kontabel neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vleren kontabel neto	25%
Mobilje dhe orendi	Mbi vleren kontabel neto	20%

Vlera e mbetur dhe jetegjatesia e aktiveve afatgjata materiale shqyrtohet, dhe rregullohet nese eshte e pershtatshme, ne çdo date te Pasqyres se pozicionit financiar. Vlera kontabel e nje aktivi shpenzohet menjehere deri ne shumen e rikuperueshme, nese vlera kontabel e aktivitetit eshte me e madhe se shuma e vleresuar e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja percaktohet duke krahasuar te ardhurat me vleren kontabel. Keto jane te perfshira ne fitimin ose humbjen e periudhes financiare.

3.5 Aktivitet afatgjata jo-materiale

Aktivitet afatgjata jo-materiale te blera nga shoqeria paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjeter nga renia ne vlere (nese ka) . bazuar ne jetegjatesine e vleresuar pas dates se ciles ato jane te gatshme per perdorim. Jetegjatesia dhe metoda e amortizimit te aktiveve afatgjata jo-materiale shqyrtohet, ne çdo date te pasqyres se pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh ne periudhat e ardhshme.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Aktive afatgjata jo materiale	Metoda lineare	15%

Vlera kontabel e aktiveve jo-financiare te shoqerise , pervec inventarit dhe aktiveve tatimore te shtyra, shqyrtohen ne çdo date te pasqyres se pozicionit financiar per te percaktuar nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ndonje tregues i tille ekziston , atehere vlera e rikuperueshme e aktivitetit rivleresohet. Kur vlera kontabel e tejkalon vleren e rikuperueshme, njihet nje humbje nga zhvleresimi. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

3.6 Zhvleresimi i aktiveve jo-financiare

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabel e nje aktivi ose njesise gjeneruese te mjeteve monetare eshte me e vogel se vlera e tij e rikuperueshme. Nje njesi gjeneruese e mjeteve monetare eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse monetare ne menyre te pavarur nga aktivitet apo grupet e tjera te aktiveve. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e nje aktivi ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare eshte vlera me e madhe midis vleres ne perdorim dhe vleres se drejte minus koston e shites. Ne vleresimin e vleres ne perdorim, flukset monetare te ardhshme skontohehen per ti sjelle ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rrezikun specifik te aktivitetit.

Ne lidhje me aktivitet e tjera, nje humbje nga zhvleresimi rimerret ne qofte se ka ndonje tregues qe ky zhvleresim nuk ekziston me dhe ka pasur ndryshime ne vleresimet e perdorura per te percaktuar vlerat e rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi rimerret deri ne masen qe vlera kontabel e aktivitetit nuk e kalon vleren kontabel qe do te ishte percaktuar, neto nga amortizimi dhe zhvleresimi, ne qofte se asnje humbje nga zhvleresimi nuk eshte njohur.

3.7 Inventaret

Inventaret maten me vleren me te vogel midis kosos dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme eshte çmimi i vleresuar i shitjes ne rrjedhen normale te biznesit. minus kosot e çmuara te perfundimit dhe kosot e çmuara qe duhen per realizimin e shitjes.

Kosot e inventarit percaktohen duke u bazuar ne metoden e mesatares se ponderuar . e cila perfshin te gjitha kosot e blerjes. transportit. tarifet doganore dhe sigurimit gjate transportit. kosot e konvertimit dhe çdo kosto tjeter qe lidhet me inventarin per te sjelle ate ne vendin dhe kushtet e punes.

3.8 Instrumentet financiare

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqeria behet pale e dispozitave kontraktuale te instrumentave financiare dhe matet fillimisht me vleren e drejte te rregulluar per kosot e transaksionit, me perjashtim te atyre te mbajtura me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes te cilat fillimisht jane te matura me vleren e drejte dhe kosot e transaksionit jane shpenzuar ne fitimin ose humbjen.

i. Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare:

SNRF 9 permban tre kategori kryesore te klasifikimit per aktivitetet financiare: matur me koson e amortizuar, vleren e drejte nepermjet te ardhurave te tjera permbledhese ose me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 ne pergjithesi bazohet ne modelin e biznesit ne te cilin menaxhohet nje aktiv financiar dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale te aktivitetit financiar. SNRF 9 permban tre kategori kryesore te klasifikimit per aktivitetet financiare: te matura me koson e amortizuar, vleren e drejte nepermjet te ardhurave te tjera permbledhese ose me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 bazohet pergjithesisht ne modelin e biznesit ne te cilin nje aktiv financiar menaxhohet dhe karakteristikave te flukset monetare kontraktuale.

Modeli i biznesit percaktohet per aktivitetet financiare individuale (ne nivel individual) bazuar ne te gjitha evidencen perkatese per aktivitetet qe Shoqeria ndermerr per te arritur objektivin e caktuar per aktivitetin individual ne dispozicion ne daten e vleresimit. Faktoret qe konsiderohen nga Shoqeria ne percaktimin e modelit te biznesit perfshijne: qellimin e aktivitetit, pervojen e kaluar ne menyren se si jane arketuar flukset e mjeteve monetare per aktivitetet perkatese, si vleresohen dhe menaxhohen rreziqet, si vleresohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxheret.

Shoqeria identifikoi se:

- Rreziqet kryesore te modelit te biznesit jane ne perputhje me modelin “mbajtja per te mbledhur”, me fokus ne rrezikun e kredise. Asnje peshe nuk i jepet riskut te çmimit ose vleres se drejte;
- Deri tani nuk ka pasur asnje shitje. Shitjet do te ndodhin vetem ne pergjigje te perkeqesimit te riskut te kredise, qe rezulton nga shkeljet e kriterave te brendshme te riskut te kredise. Keto shitje do te ishin ne perputhje me nje model biznesi “mbaj per te mbledhur”. Nje shitje per shkak te plotesimit te nevojave te likuiditetit do te ishte rastesore.

Prandaj, modeli i biznesit qe lidhet me Llogarite e arketueshme konsiderohet te jete “mbajtje per te mbledhur”.

Kur modeli i biznesit ka si objektive mbajtjen e aktiveve per mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe per te shitur, Shoqeria vlereson nese flukset e mjeteve monetare perfaqesojne vetem pagesa te principali dhe interesi ("VPPI"). Gjate ketij vleresimi, Shoqeria konsideron nese flukset e mjeteve monetare kontraktuale jane ne perputhje me nje marreveshje baze te huadhenies, pra interesi perfshin vetem shumen per riskun e kredise, vleren kohore te parase, rreziqet e tjera baze te huadhenies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj riskut ose pagendruesmerise qe nuk eshte ne perputhje me

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

nje marreveshje baze te huadhenies, aktivi financiar klasifikohet dhe matet me VDNFH. Vleresimi i VPPI kryhet ne njohjen fillestare te nje aktivi dhe nuk rivleresohet me pas.

Percaktimin nese flukset e mjeteve monetare te nje aktivi financiar jane vetem pagesa te principalit dhe interesit kerkon gjykim. Llogarite e arketueshme te Shoqerise perfshijne nje fluks te vetem te parase, pagesen e shumes qe rezulton nga nje transaksion ne fushen e SNRF 15, qe konsiderohet te jete principali. Rrjedhimisht, flukset monetare qe rrjedhin nga te arketueshmet plotesojne testin VPPI te pagesave te principalit dhe interesit pavaresisht se perberesi i interesit eshte zero.

ii. Zhvleresimi i aktiveve financiare

Shoqeria mat humbjet e pritshme te kredise per aktivet e matura me koston e amortizuar, qe perfshijne llogarite e arketueshme dhe te tjera te arketueshme dhe mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.

Shoqeria ka zgjedhur te mase humbjet e pritshme te kredise per llogarite e arketueshme ne nje shume te barabarte me totalin e HPK pergjate jetes se aktivitetit, duke perdorur nje matrice provizionimi ne te cilen fondet per humbjet llogariten bazuar mbi norma te humbjeve te pritshme per llogarite e arketueshme qe i perkasin periudhave te ndryshme te maturimit apo vonesave.

Normat e humbjes se pritshme te kredise bazohen ne profilin e pagesave te shitjeve per nje periudhe 3 vjeçare perpara 1 janarit 2020 dhe humbjeve korresponduese historike te kredise gjate asaj periudhe. Normat historike te humbjeve korrigjohen per te pasqyruar informacionin aktual dhe te ardhshem per faktoret makroekonomike qe mund te ndikojne ne aftesine e klienteve per te shlyer llogarite e arketueshme.

Aktivet financiare fshihen teresisht ose pjeserisht, kur Shoqeria ka kryer çdo perpjekje per rimarrjen dhe ka arritur ne perfundimin se nuk ka pritshmeri te arsyeshme per rimarrjen. Fshirja perfaqeson nje rast te çregjistrimit. Treguesit qe nuk ka pritshmeri te arsyeshme te rimarrjes perfshijne shkelje te kushteve te kontrates si vonesa ne pagesa ose ngjarje te mospagimit, paaftesi paguese dhe falimentim. Shoqeria mund te fshije aktivet financiare qe jane ende subjekt i zbatimit me force te marreveshjes ku Shoqeria kerkon te rikuperoje shumatat qe jane te arketueshme sipas termave kontraktuale, dhe megjithate, nuk ka pritshmeri te arsyeshme per marrjen e tyre.

Shoqeria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose te drejtat per flukset e mjeteve monetare nga aktivet perfundojne ose (b) Shoqeria ka transferuar te drejtat per arketimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyre ne nje marreveshje likuidimi nderkohe qe (i) transferon thelbesisht te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesis se aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronesis, por nuk ruan kontrollin e ketyre aktiveve.

Kontrolli ruhet ne qofte se pala tjetere nuk ka aftesine praktike per te shitur aktivin ne teresi tek nje pale e trete e palidhur pa pasur nevojte te vendose kufizime shtese per shitjen.

3.9 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston ne mjetet monetare te kontribuara nga themeluesit e shoqerise. Kapitali aksionar paraqitet me vleren ne Lek te konvertuar me kursin e kembimit te dates se transaksionit. Kapitali aksionar i shoqerise njihet me vlere nominale.

3.10 Njohja e te ardhurave

Sipas SNRF 15 te ardhurat njihen ne masen qe eshte pothuajse e sigurte se nje kthim ne sasine e te ardhurave te akumuluar te njohura nuk do te ndodhe. Keshtu e ardhura matet duke u bazuar ne shumen e percaktuar ne nje

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

kontrate me klientin ose ne listen e cmimeve te Shoqerise. Shoqeria e njeh te ardhuren atehere kur ajo transferon kontrollin mbi sherbimin ose mallin tek klienti.

Shoqeria njeh te ardhuren ne nje pike ne kohe qe perfaqesohet nga momenti qe klienti pranon sherbimet ose mallrat e ofruara nga shoqeria si edhe merr persiper rreziket e ketij transferimi te sherbimeve ose mallrave, me supozimin se nuk do te kete kthime te rendesishme ne to.

Shitjet e sherbimeve:

Te ardhurat njihen gjate kohes kur ofrohen sherbimet. Faza e perfundimit per percaktimin e shumes se te ardhurave per t'u njohur vleresohet bazuar ne anketat e punes se kryer. Nese sherbimet sipas nje marreveshjeje te vetme jepen ne periudha te ndryshme raportimi, atehere shuma ndahet ne baze te cmimeve te tyre te shitjes.

Pasqyra e meposhtshme jep te dhena ne lidhje me natyren dhe kohen e permbushjes se detyrime kontraktuale me klientet, perfshi termat kryesore te pageses dhe politikat Politikat e njohjes se te ardhurave.

Lloji i mallit /Sherbimit	Natyra dhe koha e permbushjes se kerkesave te arketueshme kontraktuale perfshi termat kryesore te pageses	Politikat e njohjes se te ardhurave
Shitja e produkteve	Klientet perfitojne kontrollin e produkteve kur ata marrin te mirat. Faturat perkatese gjenerohen ne kete moment ne kohe.	Shoqeria e njeh te ardhuren atehere kur ajo transferon kontrollin mbi sherbimin ose mallin tek klienti. Per kontratat qe lejojne klientet te kthejne nje product, te ardhurat njihen deni ne masen qe ka me shume mundesi qe nje pjese e te ardhurave nga shitja e regjistruar te mos realizohet.
Shitja e sherbimeve	Klientet perfitojne sherbimin kur ata e marrin ate. Faturat perkatese gjenerohen ne kete moment ne kohe.	Shoqeria e njeh te ardhuren atehere kur ajo transferon kontrollin mbi sherbimin ose mallin tek klienti.

3.11 Perfitimet e punonjesve

Kontributet e detyrueshme per sigurime shoqerore

Gjate ushtrimit te aktivitetit operativ, shoqeria kryen pagesa periodike per llogari te punonjesve per pjesen qe ligjerisht i takon te paguaje shoqerise dhe punonjesve per te kontribuar per fondet e detyrueshme te pensioneve sipas rregullimeve te legjislacionit vendas. Kostot e shoqerise jane perfshire ne llogaritjen e rezultatit te periudhes.

3.12 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyre

Shpenzimet per tatim fitimin perfshijne tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyre. Shpenzimet per tatim fitimin njihen ne fitim ose humbje deri pervec pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhurat e tjera permbledhese.

Tatimi mbi fitimin aktual eshte tatimi i pagueshem mbi te ardhurat e tatueshme duke perdorur normat e taksimit ne daten e raportimit dhe cdo rregullim i tatimit te pagueshem te lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshem eshte 15% e fitimit te tatueshem.

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

Tatim fitimi i shtyre njihet ne lidhje me diferencat e perkohshme midis vleres kontabel te aktiveve dhe detyrimeve per qellime te raportimit financiar dhe vlerave te perdorura per qellime tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat tatimore qe pritet te aplikohen per diferencat e perkohshme kur ato ndryshojne. duke u bazuar ne ligjet qe kane qene ose jane ne fuqi ne daten e raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet ne masen qe eshte e mundur qe fitime te ardhshme te tatueshme do te jene ne dispozicion per te mbuluar diferencat e perkohshme. Aktivet tatimore te shtyra rishikohen ne çdo date raportimi dhe reduktohen ne qofte se perfitimet tatimore nuk do te jene me te mundshme per tu realizuar.

3.13 Provizionet

Provizionet njihen kur shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve te kaluara dhe eshte e mundur qe nje rrjedhje e burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike do te jete e nevojshme per te shlyer detyrimin dhe kur nje vleresim i besueshem i vleres se detyrimit mund te behet. Nese efekti eshte material. provizionet llogariten duke zbritur vleren e pritshme te mjeteve monetare te ardhshme para tatimit qe reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase. dhe kur eshte e nevojshme rrezikun specifik te detyrimit. Provizionet rishikohen ne çdo date raportimi dhe nese nuk eshte me e mundshme qe nje dalje e burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike do te kerkohet per te shlyer detyrimin. provigjoni anulohet. Provizionet perdoren vetem per qellimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen per humbje te ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne kontabilitet

Provizionet per kthimin e mallrave te shitura do te njihen si “detyrime per kthimin e shitjeve” per vleren e te ardhurave nga shitja e tyre me kundraparti pakesimin e te ardhurave nga shitja; dhe “te drejta per kthimet e shitjeve” per te pasqyruar te drejten per te rimarre produktet nga konsumatoret ne zgjidhjen e pergjegjesise per rimbursim, me kundraparti pakesimin e koston se mallrave te shitura.

3.14 Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjete monetare perfshijne mjete monetare ne arke, llogari rrjedhese ne banka dhe mjete te tjera likuide me maturitet jo me shume se tre muaj te cilat jane subjekt i ndryshimeve jo-sinjifikative te ndryshimeve ne vleren e tyre te tregut dhe qe perdoren nga Shoqeria ne manaxhimin e angazhimeve te saj afatshkurtra. Mjetet monetare mbahen ne vleren e tyre te amortizuar ne pasqyren e pozicionit financiar.

3.15 Huamarrjet

Huatë janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë, neto nga kostot e hasura të transaksionit dhe në vazhdim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.16 Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen ne shenimet shpjeguese nese mundesia e daljes se burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte e ulet. Aktivet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare por paraqiten ne shenimet shpjeguese kur mundesia e te ardhurave ekonomike eshte e mundshme. Shuma e nje humbje te kushtezuar njihet si provigjon nese eshte e mundshme qe ngjarje te ardhshme do te konfirmojne provigjonin. nje detyrim njihet ne daten e Pasqyres e pozicionit financiar kur nje vleresim i pranueshem i humbjes mund te behet ne menyre te besueshme.

3.17 Transaksionet me palet e lidhura

Palet e lidhura perbehen nga aksionare dhe drejtoret e shoqerise. se bashku me entitete qe ata kontrollojne. te cilet mund te ushtrojne influence te konsiderueshme ne operacionet dhe menaxhimin e shoqerise. Duke konsideruar çdo pale te mundshme . vemendje i kushtohet thelbit te marredhenies dhe jo vetem formes ligjore.

4 Menaxhimi i rrezikut financiar

4.1 Faktoret e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqerise e ekspozojne ate ndaj nje shumellojshmerie rreziqesh financiare. qe perfshijne rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit ne kursin e kembimit te monedhave te huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut te shoqerise fokusohet ne paparashikueshmerine e tregjeve dhe synon te minimizojte efektet potenciale te kunderta mbi performancen e biznesit te shoqerise. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar ne politika te aprovuara dhe procedura qe mbulojne gjithe menaxhimin e rrezikut. si dhe çeshtje specifike, si rreziku i kursit te kembimit, rreziku i normes se interesit, rreziku i kreditit, dhe investimi i likuiditetit te tepert.

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i kursit te kembimit

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj rrezikut te kursit te kembimit qe vjen si rezultat i ekspozimit ne monedha te ndryshme kryesisht ne lidhje me Euro-n. Shoqeria nuk perdor ndonje instrument per tu mbrojtur ndaj rrezikut te kursit te kembimit. Drejtimi i shoqerise eshte pergjegjes per te mbajtur pozicione neto te pershtatshme ne çdo monedhe dhe ne total dhe te monitoroje operacionet e perditshme.

Flukset monetare dhe rreziku i vleres se drejte te normes se interesit

Shoqeria eshte e ekspozuar ndaj ndikimeve qe luhatjet ne nivelet e normes se interesit qe mbizoterojne ne treg kane ne bilancin kontabel dhe flukset e saj te parase. Drejtimi i shoqerise eshte pergjegjes per monitorimin ditor te pozicionit te rrezikut te normes neto te interesit dhe vendos limite per te reduktuar ndikimin e luhatjes te normes se interesit. Nuk ka perqendrim te fondeve te marra hua me interes nga institucionet financiare ose entitete me norme interesi variabel ne daten e raportimit. Luhatjet e normes se interesit te tregut me te cilen jane marre fonde hua mund te kene efekt negativ ne performancen financiare te shoqerise. Ne te njejten kohe shoqeria nuk ka vendosur aktive te shumta ne depozita me afat duke perfituar te ardhura interesi shtese.

4.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit eshte rreziku qe Shoqeria do te vihet ne veshtiresi per te perbushur detyrimet kontraktuale qe lidhen me detyrimet financiare qe shlyhen ne para ose nepermjet nje aktivi tjetër financiar. Qasja e Shoqerise ndaj administrimit te likuiditetit eshte e tille qe te siguroje, sa te jete e mundur qe do te kete mjaftueshem likuiditet per te shlyer detyrimet e saj kur te maturohen, ne kushte normale dhe nen shtypje nga faktoret e tregut, pa shkaktuar humbje te papranueshme ose te rezikoje reputacionin e Shoqerise.

Ne vijim jane afatet e maturimit te kontratave te detyrimeve financiare ne daten e raportimit.

4.4 Vleresimi me vlere te drejte

Vlera e drejte perfaqeson vleren me te cilen nje aktiv mund te zevendesohet ose nje detyrim te shlyhet ne kushtet e tregut. Vlera e drejte eshte bazuar ne supozimin e drejtimit ne perputhje me profilin e bazes se aktivitetit dhe te detyrimit.

Aktivitetet financiare te matura me vlere te drejte ne pasqyren e pozicionit financiar jane ne perputhje me hierarkine e vleres se drejte e cila i grupon aktivet dhe detyrimet financiare ne tre nivele bazuar ne rendesine e te dhenave te perdorura gjate matjes se vleres se drejte te aktiveve financiare. Hierarkia e vleres se drejte eshte si vijon:

Niveli 1: çmimet e kuotuar (te pakorrigjuara) ne tregjet aktive per aktive ose detyrime financiare te ngjashme;

- **Niveli 2:** te dhena te tjera pervec çmimeve te kuotuar te perfshira ne Nivelin 1 qe jane te disponueshme per aktivet dhe detyrimet e observuara. direkt (p.sh. çmimet) ose indirekt (te dhena nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** te dhena mbi aktivet dhe detyrimet qe nuk jane te bazuar ne te dhena te disponueshme nga observimi i tregut

5. Gjykime dhe vleresime te rendesishme kontabel

Ne aplikimin e politikave kontabel te shoqerise, qe pershkruhen ne Shenimin 3 te ketyre pasqyrave financiare, drejtimit i kerkohet qe te beje gjykime, çmuarje, dhe supozime per vleren kontabel te aktiveve dhe detyrimeve qe nuk jane qartesisht te dukshme nga burime e tyre. Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to jane te bazuara ne eksperiencen historike dhe faktore te tjere qe konsiderohen te rendesishem. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Ndryshimet ne çmuarjet kontabel do te njihen ne periudhen ne te cilen çmuarja eshte rishikuar ne qofte se rishikimi ndikon vetem ate periudhe ose ne periudhen e rishikimit dhe ne periudhat e ardhshme ne qofte se rishikimi ndikon periudhen aktuale dhe ato te ardhme.

Pasiguria ne gjykime Zhvleresimi i aktiveve jo-financiare

Humbjet nga zhvleresimi do te njihen me shumen me te cilen vlera kontabel e aktiveve ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare tejkalon vleren e rikuperueshme. Kur percaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlereson çmimet e pritshme dhe flukset e parase nga çdo njesi gjeneruese te mjeteve monetare dhe percakton nje norme interesi te pershtatshme kur llogaritet vlera aktuale e ketyre flukseve te parase.

Jeta e dobishme e aktiveve te amortizueshme

Drejtimi rishikon ne menyre te vazhdueshme jeten e dobishme te aktiveve te mbajtura me kosto te amortizuar ne daten e pasqyres se pozicionit financiar. Drejtimi vlereson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmerine e pritur te ketyre aktiveve. Vlera e mbetur e ketyre aktiveve eshte analizuar ne Shenimin Nr. 6. Megjithate, rezultatet reale mund te ndryshojne per shkak te konsumimit teknologjik.

Inventari eshte paraqitur me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Gjate percaktimit te vleres neto te realizueshme, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive/ te dhenat e disponueshme per kryerjen e vleresimeve.

Zhvleresimi i llogarive te arketueshme Matja Humbjeve te pritshme te kreditimit

HPC-te jane vleresime te humbjeve nga kreditimi te vleresuara ne baze te treguesve te propabilitetit. Humbjet nga kreditimi maten si vlera e aktualizuar e arketimeve te munguara (psh. ndryshimi midis flukset monetare hyrese ne baze te te drejtave te arketueshme kontraktuale dhe flukset monetare hyrese qe priten ne nivel grupi). HCP-te zbriten me normen efektive te interest te aktivitet financiar.

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

6. Aktive afatgjata materiale

RIVLERESIM ME KOSTO	Toka	Ndërtesa	Maki. paisje	Transporti	Te tjera	Në Proces	TOTALI
Pozicioni në datën 01-01-2019	490,700,000	173,890,624	16,043,713	234,156,999	29,145,281	757,645,465	1,701,582,082
Shtesa			1,292,415	386,667		635,040	2,314,122
Transferime							0
Pakesime				-30,000			-30,000
Pozicioni në datën 31-12-2019	490,700,000	173,890,624	17,336,128	234,513,666	29,145,281	758,280,505	1,703,866,204
AMORTIZIMI AKUMULUAR							
Pozicioni në datën 01-01-2019	0	8,694,531		19,587,093	936,280	0	29,217,904
Shtesa				21,479,768	5,641,800		27,121,569
Transferime						0	0
Pakesime							
Pozicioni në datën 31-12-2019	0	8,694,531		41,066,861	6,578,080	0	56,339,473
VLERA NETO KONTABEL							
Pozicioni në datën 01-01-2019	490,700,000	165,196,093	16,043,713	214,569,906	28,209,001	757,645,465	1,672,364,177
Pozicioni në datën 31-12-2019	490,700,000	165,196,093	17,336,128	193,446,804	22,567,201	758,280,505	1,647,526,731

7. Aktive afatshkurtra

Inventare dhe aktive biologjike afatshkurter
Llogari te arketueshme tregtare
Te drejta te tjera financiare afatshkurter
Mjete monetare dhe ekuivalente me to

2019	2018
1,358,759,801	470,773,783
1,522,339,502	1,044,063,430
292,137,323	292,137,323
2,124,256	7,294,789
3,175,360,882	1,814,269,325

7.1 Llogari te arketueshme tregtare (disa nga detyrimet debitore)

FARMACI 24	9,323,518
Farmaci Blerta Tirane	10,133,515
Depo ERMED Shpk	12,303,356
Farmaci Alba Tirane	12,744,205
Spitali Rajonal Vlore	13,283,835
Spitali Gjirokaster	13,314,205
Farmaci Geni&Lori	14,432,405
WELL PHARMA TIRANE	18,101,665
Farmaci Bioplus SHPK	19,279,138

Albadent Group SHPK Tirane	21,237,170
Farma Net Albania	30,911,375
Qendra e Kontrollit te Barnave	35,720,721
Farma Net Albania	37,508,152
Farmaci MEDIGREEN	72,822,455
Depo Alfarmakos	135,893,416
Depo Fufarma sh.a.	273,712,007
Centrum International Albania	11,016,635
German Hospital International	33,577,008

7.2 Mjetet monetare, Gjendjet ne Banka :

	LEKE	EUR	USD
BKT	389,619	110	37
CREDINS	137,379	103	9
RAIFEISSEN	1,156,657	53	

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

INTESA	210,628	16	
ABI	62,332	35	
FIBANK	4,866	980	
	1,961,480	1,297	45
Vlerat ne LEK	1,961,480	157,881	4,895
TOTALI ne LEK		2,124,256	

8. Kapitali dhe Rezervat

Kapitali ne 31.12.2018 ishte ne vleren 1,768,890,624. Ne vitin 2019 u be rritje e kapitalit duke zvogeluar Rezerven Ligjore me 59,686,660 leke si dhe duke kaluar fitimet e pashperndara 371,422,716, ne Total =431,109,376 leke ne Kapital, i cili arrin 2,200,000,000, ne nje pjese te vetme dhe ne pronesi te Ortakut te Vetem te shoqerise, z, Nadir Çauholli.

9. Detyrime afatgjata

	2,019	2,018
Huamarrje	616,156,483	470,405,245

Te detajuara :

	EUR	LEKE
B pare INVESTIMEVE	313,518	38,645,934
ALBANIA LEASING	274,039	33,779,476
OTP BANK, KREDI	3,502,051	431,681,211
OTP BANK, KREDI ALL		63,040,523
TIRANA FACTORING	279,960	34,509,340
TIRANA FACTORING		14,500,000
	4,369,568	616,156,483

10. Detyrime afatshkurtra :

	2,019	2,018
Llogari te pagueshme tregtare dhe te tjera te pagueshme	1,227,087,526	422,459,905
Huamarrje, OVERDRAFT	491,871,198	312,745,670
Detyrime financiare te tjera, punonjes, sigurime	12,109,149	45,151,994
Detyrime per tatimin aktual dhe tvsh	29,059,009	-

10.1 Llogari te pagueshme tregtare dhe te tjera te pagueshme, (detyrimet ndaj Furnitoreve)

Disa nder me kryesoret

Depo Fu-Farma Tirane	201,065,522
“S.F. GROUP” s.r.l.	156,298,776

Depo Alfarmakos shpk	117,443,232
New Research srl	86,906,401

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

Pharmactive Ilac San Ve Tic A.S	64,688,386
Benedetti&Co. s.p.a.	53,205,717
Farma Net-Albania TR	49,297,247
INTERCHEMIA HANDELS M.B.H	43,285,571
Albadent SHPK Tirane	32,926,834
ELCOM SYSTEM	24,975,468
Depo Imi Farma	22,300,131

Depo PEGASUS sh.p.k.	16,763,082
ERMED Sh.p.k	16,429,929
Depo Express Pharma Fushe-Kruje	14,725,448
EME ASHENSOR GROUP	12,420,000
PORSCHE ALBANIA	10,892,825
A&T SH.A Tirane	10,730,947
Mega Pharma	10,108,377

10.2 Detyrime financiare te tjera, punonjes, sigurime

	2019	2018
Paga dhe shpërblime	7,964,246	6,918,548
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	2,875,116	2,543,385

11. Te ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve dhe Shpenzimet e kryera

	2,019	2,018
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	4,579,885,154	4,833,324,774
Te ardhura te tjera, zbritje ne fatura	55,715,546	57,323,918
Te tjera te ardhura (nga qirate)	2,202,321	-
	2,019	2,018
Lenda pare e materiale te konsumueshme	4,071,009,026	4,296,288,688
Shpenzime amortizimi dhe zhvleresimi	27,121,569	29,217,904
Shpenzime personeli	127,193,366	89,635,939
Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto	0	60,041,628
Shpenzime te tjera	164,065,192	107,927,850
— Shpenzime paga - punonjes	108,967,618	
— Shpenzime per Sigurimet Shoqerore	18,225,748	

11. Shpenzime të tjera

KARBURANT	50,496,191
ENERGJI ELEKTRIKE	17,085,729
UJE	594,980
UJE PUNONJES	819,410
MIREMBAJTJE AUTOMJETET	14,077,129
SIGURACION MJETET	4,165,760
SIGURACION BANKAR	1,541,615
TE NDRYSHME, KANCELERI, GJYQES, ETJ ETJ	17,925,347

UDHETIM E DIETA, ALBTOURS	23,145,272
POSTE TELEFON	6,849,249
KOMISIONE KREDIE	320,411
SHPENZIME INTERESASH	16,736,036
GJOBA E PENALITETE , FATURA	6,183
PENALITETE (Urdher sekuestro)	1,149,747
GJOBA E PENALITETE , PAGUAR	1,632,253

CFO Pharma shpk

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Lek)

TE NDRYSHME, KANCELERI,GJYQES, ETJ ETJ	2,995,627
KOMISIONE BANKARE PAGUAR	299,486
KOMISIONE BANKARE PAGUAR	717,433

TAKSA VENDORE PAGUAR	1,039,735
KOMISIONE APROVIM KREDIE	2,467,600
	164,065,192

Fitimi/(humbja) para tatimit	248,413,868
Shpenzime te pa zbritshme,	2,788,182
Te perbera nga :	
- Gjoha e penalitete te paguara	1,638,435
-Penalitet, Urdher sekuestro	1,149,747
Fitimi I Tatueshem	251,120,051
Tatimi mbi Fitimin	37,680,308
Paguar Tatim Fitim	-23,391.033
Tatim Fitim per t'u paguar	14,289,275

12. Ngjarje pas dates se raportimit

Nuk ka ngjarje te rendesishme pas dates se raportimit qe te mund te ndikojne ne keto pasqyra financiare ose paraqitje te shenimeve shtese.